

1. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

1.1 ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË BOTË

Gjatë fillimit të vitit 2011, ekonomia botërore është rritur me ritme më të ngadalësuara krahasuar me rritjen mesatare të vitit 2010. Në tremujorin e parë të vitit, norma e rritjes shënoi vlerën vjetore 4.3%, krahasuar me 5% në vitin 2010. Në tremujorin e dytë të vitit, norma vjetore e rritjes ekonomike zbriti në 3.7%, rreth 1.6 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Këto zhvillime kanë reflektuar kostot më të larta të tregjeve financiare për financimin e investimeve, si edhe ngadalësimin e kërkesës agregate të sektorit privat që ka përforcuar efektin e uljes së shpenzimeve publike si rezultat i përpjekjeve për konsolidim fiskal.

Ritmet e rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara krahasuar me ato në zhvillim, kanë patur një diferencë të theksuar. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, vendet e zhvilluara kanë shënuar një rritje prej 1.5%, kundrejt 6.8% të vendeve në zhvillim. Gjatë këtij gjashtëmuori, edhe norma e inflacionit në nivel botëror shënoi rritje kryesisht për shkak të ecurisë në rritje të çmimeve të lëndëve të para. Gjithsesi, ecuria e ardhshme e presioneve inflacioniste vlerësohet të jetë në ulje, për shkak të zbutjes së presioneve për rritje të çmimeve të energjisë dhe të lëndëve të para. Për shkak të ritmit më të lartë të rritjes ekonomike, vendet në zhvillim priten të ndeshen me presione më të larta inflacioniste.

Pasiguria që shkakton madhësia e borxheve publike, nivelet e dobëta të konsumit, kushtet e shtrënguara të financimit si edhe kufizimi i ndjeshëm i mundësive për politika ekonomike stimuluese nga autoritetet publike, kanë ulur parashikimet për rritjen e ekonomisë botërore gjatë vitit 2011, në nivelin 4%. Vendet e zhvilluara do të vijojnë të kenë një rritje modeste kryesisht për shkak të ecurisë së ngadalësuar të ekonomisë së SHBA dhe asaj të Eurozonës. Ndërkohë, ulja e kërkesës së huaj do të reflektohet në një rritje ekonomike të vendeve në zhvillim prej 6.4% gjatë 2011 krahasuar me 7.3% të një viti më parë.

Ekonomia e SHBA. Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, ekonomia e SHBA është rritur me ritme të ngadalësuara. Në terma vjetorë, ajo u rrit me 0.4% në tremujorin e parë dhe me 1.0% në tremujorin e dytë, duke reflektuar në mënyrë të ndjeshme ngadalësimin e konsumit i cili shënoi një rritje prej vetëm 0.1% në tremujorin e dytë. Kontributi i shpenzimeve publike në rritjen ekonomike ka ardhur në rënie, pasi ato u pakësuan në terma vjetorë me 5.8% në tremujorin e parë dhe me 1.1% në tremujorin e dytë. Në përgjithësi, rimëkëmbja ekonomike e SHBA mbetet e pasigurtë, në kushtet kur ecuria e

tregut të shtëpive dhe shpenzimeve konsumatore mbetet e dobët, ndërsa niveli i borxhit publik është tepër i lartë. Për pjesën e mbetur të vitit, parashikimet për ecurinë e ardhshme të ekonomisë së SHBA reflektojnë ngadalësimin e dy tremujorëve të parë të vitit.

Në fund të tremujorit të dytë, për shkak të rritjes në nivele shumë të ulëta të vendeve të punës, norma e papunësisë në SHBA shënoi vlerën 9.2%¹⁷, 0.1 pikë përqindje më e lartë se muaji maj. Vlera më e lartë e normës së papunësisë në SHBA është shënuar në muajin tetor 2009 me 10.1% dhe vlera më e ulët pas krizës, në muajin mars 2011 me 8.8%. Procesi i ristrukturimit dhe shkurtimeve të shpenzimeve nga bizneset do të kenë ndikim negativ në nivelin e punësimit, duke vështirësuar kthimin e tij në nivelet e para-krizës. Projektionet për ecurinë e tregut të punës në SHBA sugjerojnë se ai do vijojë të jetë i dobët, me një ulje të ngadaltë të normës së papunësisë.

Ecuria e çmimeve në tregun e shtëpive tregon për një rritje të lehtë në muajin maj krahasuar me muajin prill me rreth 0.4%¹⁸. Në fund të tremujorit të parë, Indeksi i Çmimit të Banesave shënoi një rritje prej 0.2%. Gjithsesi për periudhën e kaluar dymbëdhjetë mujore deri në maj 2011, indeksi ka shënuar rënie me 6.3% duke qëndruar 19.6% poshtë vlerës së nivelit të tij më të lartë në muajin prill 2007 dhe pothuajse në të njëjtin nivel me vlerën në muajin janar 2004. Projektionet për tregun e shtëpive në SHBA tregojnë se ai do të vijojë të mbetet i dobët.¹⁹

Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, të ardhurat e individëve mbeten ende në nivele të ulëta dhe treguesi i besimit të konsumatorit ka shfaqur rënie në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2010, ndonëse paraqitet në nivele më të larta krahasuar me fundin e vitit paraardhës. Norma e interesit është mbajtur e pandryshuar përgjatë gjithë periudhës nga ana e Rezervës Federale, në nivelin 0.25%. Ndërkohë çbalancimet fiskale në SHBA vijojnë të zgjerohen, më një rritje të borxhit bruto të qeverisë në nivelin 78.4% të PBB në tremujorin e parë 2011. Gjatë së njëjtës periudhë, deficitin në terma të PBB u ngushtua në 9.9% të PBB krahasuar me 10.7% të një viti më parë.

Tabelë 1. Ecuria e disa treguesve kryesorë të ekonomisë së SHBA-ve gjatë periudhës 2010-2011.

	T1'10	T2'10	T3'10	T4'10	T1'2011	T2'2011
Rritja reale e PBB-së (% vjetore)	3.9	3.8	2.5	2.3	0.4	1.0
Norma vjetore e inflacionit (%)	2.4	1.8	1.2	1.5	2.7	3.6
Norma vjetore e papunësisë (%)	9.7	9.6	9.6	9.6	8.8	9.2
Deficiti buxhetor (në % ndaj PBB-së)	-10.7	-11.1	-10.4	-10.3	-9.9	..
Borxhi bruto i qeverisë (në % ndaj PBB-së)	71.7	73.3	75.3	77.4	78.4	..

Burimi: Bureau of Economic Analysis, Bureau of Labor Statistics

Parashikimet për ecurinë e ardhshme të ekonomisë së SHBA reflektojnë ngadalësimin e dy tremujorëve të parë të vitit. Sipas FMN²⁰, deri në fund të vitit 2011 SHBA do të rritet me rreth 1.5% dhe në fund të 2012 me rreth 1.8%.

¹⁷ Bureau of Labor Statistics

¹⁸ Federal Housing Finance Agency

¹⁹ ECB, Financial Stability Review, July 2001

²⁰ World Economic Outlook, September 2011

Ekonomia Evropiane. Vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe të Eurozonës kanë shënuar një rritje të diferencuar gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2011. Rritja e tyre ishte mesatarisht 2.5% në tremujorin e parë të vitit, krahasuar me 1.9% në të njëjtën periudhë të vitit 2010. Edhe në terma tremujorë, ecuria e ekonomisë është pozitive, me një normë rritjeje prej 0.8% në tremujorin e parë të vitit 2011, krahasuar me 0.3% rritje tremujore në fund të 2010. Në rritjen ekonomike, kontributin kryesor e dhanë qëndrueshmëria e konsumit dhe e shpenzimeve qeveritare. Kontributin kryesor në këtë rritje ekonomike e dha Gjermania e cila raportoi një rritje tremujore prej 1.5%, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe konsumit si rezultat i rënies së normës së papunësisë. Për periudhën tremujore, edhe Greqia shënoi një rritje të papritur prej 0.8% krahasuar me rënie prej 2.8% në tremujorin e fundit të vitit 2010. Si rezultat, në fund të tremujorit të parë të vitit 2011, rënia ekonomike vjetore e Greqisë ishte 4.8%, krahasuar me rënie prej 7.8% gjatë vitit 2010. Portugalia ka filluar të ndjejë ngushtimin ekonomik reflektuar në një rënie ekonomike për të dytin tremujor radhazi. Në fund të marsit 2011, ekonomia e Portugalisë u ngushtua me 0.7% duke vijuar rënie ekonomike të nisur në fund të 2010 prej 0.6%. Këto zhvillime në ekonomi vijnë pas shtrëngimeve të vendit si rezultat i përfitimit nga marrëveshjet me FMN dhe BE. Të dhënat paraprake për ritmin e rritjes gjatë tremujorit të dytë në vendet e BE-së dhe të Eurozonës, tregojnë për një normë rritjeje më të ulët, rreth 1.7%. Këto zhvillime i referohen ngadalësimit të ritmit të rritjes ekonomike në Gjermani, i cili u përgjysmua në vlerën vjetore 2.8%, dhe mungesës së rritjes ekonomike në Francë.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë në BE dhe Eurozonë.

	Rritja e PBB-së				Inflacioni				Papunësia			
	(% normë vjetore)				(% normë vjetore)				(%)			
	T3 2010	T4 2010	T1 2011	T2 2011	T3 2010	T4 2010	T1 2011	T2 2011	T3 2010	T4 2010	T1 2011	T2 2011
BE	2.2	2.2	2.5	1.7	2.2	2.6	2.93	3.20	9.7	9.7	9.5	9.40
Eurozonë	2.0	2.0	2.5	1.7	1.8	2.2	2.47	2.73	10.0	10.0	9.97	9.90
Gjermani	3.9	3.8	4.6	2.8	1.3	1.9	2.17	2.50	6.6	6.6	6.3	6.13
Francë	1.7	1.4	2.1	1.6	1.8	2.0	2.00	2.23	9.7	9.7	9.7	9.70
Itali	1.4	1.5	1.0	0.8	1.6	2.1	2.27	2.97	8.5	8.6	8.1	8.03
Greqi	-4.1	-7.4	-4.8	..	5.7	5.2	4.47	3.30	12.2	14.1	15.0	..
Jo-eurozonë												
Mbretëri e Bashkuar	2.5	1.5	1.6	0.7	3.1	3.4	4.13	4.40	7.8	7.8	7.67	7.7*

Burimi: Eurostat, Publikim i Eurostat i datës 16.08.2011.


*E dhënë e muajit prill 2011

Gjashtëmujori i parë i vitit 2011 është shoqëruar edhe me rritje të normave të inflacionit në vendet e BE dhe ato të Eurozonës. Në BE norma e inflacionit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 u ngjiti në 3.2%, 1.3 pikë përqindje më lart se norma e rritjes së çmimeve gjatë tremujorit të parë. Për të njëjtën periudhë, në zonën e Euros norma mesatare e inflacionit rezultoi 2.73%. Si rrjedhim, Banka Qendrore Evropiane rriti normën bazë të interesit në muajin prill, me shqetësimin se inflacioni do të vijojë të qëndrojë mbi nivelin e synuar prej 2% gjatë muajve në vazhdim. Ndërkohë, Banka e Anglisë vijoi të mbajë normën bazë në nivelin më të ulët historik prej 0.5% pavarësisht rritjes së normës së inflacionit përtej objektivit. Dobësia e rritjes ekonomike në Mbretërinë e

Bashkuar dhe pasiguria për ecurinë e saj në të ardhmen, ka përcaktuar këtë qëndrim të bankës qendrore.

Ndonëse zhvillimet ekonomike në BE janë përgjithësisht pozitive, ndikimi i tyre në përmirësimin e tregut të punës, ka qenë i dobët. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, norma e papunësisë në BE u përmirësua vetëm me 0.3 pikë përqindje krahasuar me fundin e 2010. Në vendet e Eurozonës, ky përmirësim ishte vetëm me 0.1 pikë përqindje.

Qeveritë e vendeve të Eurozonës kanë vijuar me politikat e tyre të konsolidimit fiskal, diktuar nga situata e vështirë e borxhit publik. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2011, deficitin buxhetor të Eurozonës shënoi vlerën 5.8% të PBB-së, rreth 2.2 pikë përqindje më pak se i njëjti tremujor i një viti më parë. Por borxhi publik vijon të mbetet në nivele të larta duke arritur vlerën 86.2% të PBB-së gjatë tremujorit të parë 2011 nga 81.2% të PBB-së që shënonte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Pritshmëritë për të ardhmen tregojnë që vendet e BE-se do të karakterizohen nga ritme të ndryshme të ecurisë ekonomike. Ndonëse me një ritëm rritjeje më të ulët, Gjermania do të vijojë të shënojë një rritje ekonomike më të lartë se mesatarja e vendeve të BE-së. Franca, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar, do të kenë një rritje më të dobët ekonomike. Punësimi në zonën e BE-së do të vijojë të përmirësohet por në mënyrë graduale dhe modeste. Në fund të vitit 2011, norma e inflacionit pritet të shënojë vlerën 2.5% për Eurozonën dhe 3.0% për BE. Këto zhvillime në çmime reflektojnë qëndrueshmërinë e çmimeve të lëndëve të para dhe të energjisë, por edhe një ngadalësim të rritjes së pagave.

Tabelë 3. Treguesit kryesorë makroekonomike në Evropë.

	PBB reale (%)		Inflacioni (%)		Papunësia (%)	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011
Evropë	2.2	2.0	2.4	3.1	9.6	9.5
Eurozonë	1.8	1.6	1.6	2.5	10.1	9.9
Gjermani	3.6	2.7	1.2	2.2	7.1	6.0
Francë	1.4	1.7	1.7	2.1	9.8	9.5
Itali	1.3	0.6	1.6	2.6	8.4	8.2
Spanjë	-0.1	0.8	2.0	2.9	20.1	20.7
Greqi	-4.4	-5.0	4.7	2.9	12.5	16.5
Holandë	1.6	1.6	0.9	2.5	4.5	4.2
Belgjikë	2.1	2.4	2.3	3.2	8.4	7.9
Britani e Madhe	1.4	1.1	3.3	4.5	7.9	7.8
Irlandë	-0.4	0.4	-1.6	1.1	13.6	14.3

Burimi: "World Economic Outlook", Shtator 2011

Zhvillimet në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore²¹, ripërtëritja e aktivitetit ekonomik është theksuar në gjashtëmujorin e fundit, kryesisht e drejtuar nga kërkesa e jashtme. Ndërkohë, kërkesa e brendshme është kufizuar nga tregjet e dobëta të punës, çmimet e larta të lëndëve të para, si edhe nga efektet afatshkurtra të konsolidimit fiskal. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) në terma realë është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në disa nga këto vende. Inflacioni paraqitet disi më i lartë se në fund të 2010 për pjesën kryesore të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore, veçanërisht në tremujorin e parë të 2011, duke reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve në këtë periudhë. Sidoqoftë, tremujori i dytë i vitit ka shënuar një ulje të presioneve inflacioniste. Në fund të gjashtëmujorit të parë, nivelet më të larta të normës vjetore të inflacionit në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore u regjistruan në Rumani dhe Serbi, përkatësisht me 8% dhe 12.7%.

Tabelë 4. Treguesit kryesorë makroekonomikë të vendeve të Evropës Qendrore e Juglindore

	Rritja reale e PBB-së			Inflacioni			Papunësia mujore		
	(normë vjetore në përqindje)			(normë vjetore në përqindje*)			(në përqindje*)		
	T4-10/ T4-09	T1-11/ T1-10	T2-11/ T2-10	T4-10/ T4-09	T1-11/ T1-10	T2-11/ T2-10	T4-10	T1-11	T2-11
Hungari	2.4	1.6	1.2	4.6	4.6	3.5	11.0	10.6	9.9
Çeki	2.7	2.8	2.4	2.3	1.9	1.9	7.2	6.7	6.5
Poloni	3.9	4.3	..	2.9	4.0	3.7	9.5	9.2	9.0
Rajoni i Ballkanit									
Bullgari	3.8	3.4	1.9	4.4	4.6	3.5	11.4	11.1	11.4
Rumani	-0.6	0.3	0.3	7.9	8.0	8.0	7.4	7.0	..
Serbi	1.0	3.4	2.2	10.3	14.1	12.7	19.2	..	22.2
FYROM	1.8	5.1	..	3.0	5.2	4.1	32.1	31.2	..
Vendet e Baltikut									
Estoni	6.7	8.5	8.4	5.4	5.1	4.9	14.4	13.8	..
Letoni	3.5	3.4	5.7	2.4	4.1	4.7	17.0	16.2	..
Lituani	4.6	6.8	5.9	3.6	3.7	4.8	17.3	16.3	..

Burimi: Eurostat database, Eurostat Newsrelease, bankat qendrore përkatëse

* të dhëna për muajin e fundit të tremujorit përkatës

Treguesit afatshkurtër sugjerojnë një vazhdimësi të ripërtëritjes ekonomike në periudhën e ardhshme, për shumicën e këtyre vendeve. Gjithashtu, projeksionet e rishikuara²² për Evropën Qendrore dhe Juglindore paraqiten më optimiste në krahasim me vlerësimet paraprake dhe me nivelet e vitit 2010, duke pritur prej këtij rajoni një rritje reale mesatare të PBB-së prej 4.3% për vitin 2011.

1.2 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE NË BOTË

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, kushtet financiare botërore kanë shfaqur luhatje, si pasojë e reflektimit të shqetësimeve të tregjeve lidhur me zhvillimet e rreziqeve sovrane në Evropë dhe aktivitetit të ngadalësuar ekonomik në SHBA²³. Trajektoret e ndryshme të rritjes ekonomike dhe të

²¹ Sipas ECB Monthly Bulletin, June 2011

²² World Economic Outlook, Shtator 2011

²³ World Economic Outlook, Shtator 2011

lëvizjeve të politikës monetare ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, shpjegojnë disa nga lëvizjet e tregjeve financiare në këtë periudhë.

Ndërveprimi midis dobësisë së financave publike dhe ekspozimit të sektorit financiar, perceptohet nga tregjet si një burim i rëndësishëm rreziku. Të tjera rreziqe²⁴ vijnë nga luhatjet në kostot e financimit të bankave, humbjet e tyre prej rënies së çmimeve të pasurive të paluajtshme si edhe tensionet që krijohen në treguesit makroekonomike të vendeve të veçanta prej ecurisë së flukseve ndërkombëtare të kapitalit.

Në SHBA politika monetare akomoduese dhe likuiditeti i bollshëm i kanë mbajtur të ulëta normat e interesit në tregjet e parasë. Gjatë këtij gjashtëmuorin, norma e marrëveshjeve të riblerjes njëditore në dollarë amerikanë, shënoi një minimum prej 0.01%. Në Eurozonë, normat e interesit të tregut ndërbankar


kanë patur një prirje rritëse të shfaqur gjatë gjithë periudhës gjashtëmuore. Në muajin qershor, norma EURIBOR-it për periudhën njëmuore, tremujore dhe dymbëdhjetëmuore ishte përkatësisht 1.28%, 1.49% dhe 2.14%, krahasuar me 0.81%, 1.02%, 1.53% në fund të vitit 2010. Ndërkohë edhe norma e interesit për veprimet njëditore, EONIA, u rrit ndjeshëm në 1.12% prej 0.5% në fund të dhjetorit 2010.

Gjatë këtij gjashtëmuorin, norma bazë e interesit²⁵ u rrit me 25 pikë nga Banka Qendrore Evropiane në 1.25%. Si rezultat, për veprimet me bankat, norma marxhinale e huadhënies dhe ajo e pranimit të depozitave u rritën përkatësisht në 2% dhe në 0.5%.


Për sa i përket letrave me vlerë të borxhit publik afatgjatë për ekonomitë kryesore, ecuria e tyre është diktuar prej rrezikut të borxhit sovran si edhe mundësisë për një politikë monetare shtrënguese për shkak të presioneve inflacioniste. Në të ardhmen, pasiguria për rritjen ekonomike si edhe veprimet e konsolidimit fiskal, do të rrisin ndikimin e tyre mbi ecurinë e normave të interesit të këtyre letrave me vlerë.

Në bursat kryesore të aksioneve, në SHBA dhe Evropë, indekset janë rritur në krahasim me fundin e vitit, të ndikuar nga përmirësimet në parashikimet ekonomike dhe të ardhurat e kompanive, veçanërisht për tremujorin e parë të 2011. Sidoqoftë, vështirësitë e shkaktuara në ekonominë japoneze pas tërmetit të muajit mars, dhe tensionet gjeopolitike në Afrikën

Grafik 2. Normat kryesore në tregun e parasë



Grafik 3. Normat e kthimit të obligacioneve qeveritare 10-vjecare



²⁴ Financial Stability Review, June 2011, ECB


²⁵ ECB Monthly Bulletin, June 2011

Veriore të cilat ndikuan në ecurinë e çmimit të naftës, kanë ndikuar në luhatshmërinë e këtyre tregjeve. Megjithatë, rigjallërimi i tensionit për rrezikun e borxhit sovran për Spanjën dhe Italinë, ndikoi në rënien e çmimeve në tregjet evropiane pas muajit maj 2011.

Në tregjet e këmbimit të valutave, vendimi i Rezervës Federale për mbajtjen e një politike monetare lehtësuese ka ndikuar në dobësimin e dollarit amerikan gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit. Euro ka shfaqur luhatshmëri gjatë këtij gjashtëmuori, duke u mbiçmuar në tremujorin e parë dhe duke u pasuar nga një nënçmim i mëtejshëm i saj. Nënçmimi i monedhës së përbashkët evropiane kundrejt disa monedhave në tremujorin e dytë të 2011 u ndikua nga zhvillimet fiskale kur pasiguritë mbi lëvizjet afatshkurtra në kursin e këmbimit u rritën ndjeshëm. Sidoqoftë, në fund të qershorit 2011, në krahasim me fundin e vitit 2010, monedha evropiane mbetet e mbiçmuar me 8.4% kundrejt dollarit amerikan, 5.4% kundrejt paundit britanik dhe 7.5% kundrejt jenit japonez²⁶.


Në tregjet e lëndëve të para, në krahasim me fundin e vitit 2010, çmimet janë rritur dukshëm në tremujorin e parë të 2011 për të gjitha kategoritë. Kjo rritje paraqitet në kah të kundërt me ngadalësimin e konsumit të tyre në nivel global. Rënia e përgjithshme e tyre në tremujorin e dytë të vitit, shpreh luhatshmërinë e këtyre tregjeve²⁷. Çmimet e ushqimeve u stabilizuan, pas goditjeve të mëparshme në ofertë për shkak të kushteve atmosferike. Pasiguritë mbi të ardhmen e energjisë bërthamore të shkaktuara nga kushtet e Japonisë pas tërmetit, vendosën një tjetër presion rritës mbi çmimet e naftës në këtë periudhë, veç atyre të induktuara nga tensionet politike. Indeksi total i çmimeve të lëndëve të para në fund të gjashtëmuorit ishte 195.1, rreth 40% më i lartë se një vit më parë. Nënindeksi i ushqimeve shënoi një vlerë prej 181.4, ndërsa nënindekset e metaleve dhe të naftës ishin në një nivel prej përkatësisht 235.7 dhe 199.4, me një rritje respektive në terma vjetorë prej 33.1%, 55.9% dhe 42.3% për secilin prej këtyre nënindekseve.

Grafik 4. Indekset kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Baza e të dhënave e BQE, Reuters

Grafik 5. Ecuria e kursit të këmbimit të euros kundrejt monedhave kryesore




Burimi: Eurostat, Reuters


²⁶ Kursi i këmbimit euro/dollar arriti pranë nivelit 1.45 dollarë për euro; kursi euro/paund arriti pranë nivelit 0.9 paund për euro dhe kursi euro/jen arriti në 116.79 jen për euro.

²⁷ Financial Stability Review, June 2011

Grafik 6. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para



Grafik 7. Kursi i këmbimit të arit dhe argjendit (në USD për 28.35 gramë*).



Në lidhje me metalet e çmuara, çmimi i arit mbetet i lartë. Ari ka shfaqur një rritje gjashtëmuajore prej 0.43%, ndërsa në terma vjetorë rritja e tij paraqitet në një nivel prej 6.6%. Rënia e përkohshme në fillim të vitit u pasua me një rritje në pjesën tjetër të periudhës si rezultat i kalimit të investitorëve në asete me siguri të lartë, normave të ulëta të interesit, ndikimit të kursit nominal të këmbimit të dollarit amerikan në të cilin kuotohet ky metal, si edhe zgjerimit të bazës së investimeve pas krijimit të fondeve të tregtueshme të shkëmbimit të arit (gold exchange-traded funds). Çmimet e argjendit kanë shfaqur disa luhajtje në këtë periudhë, por kanë qenë 6.7% më të larta në krahasim me një gjashtëmuajor më parë.

Ecuria e sektorit bankar, e vlerësuar nëpërmjet ecurisë së grupeve globale të mëdha e komplekse bankare (GGMKB), paraqitet e përmirësuar për tremujorin e parë të 2011, duke u bazuar në kapacitetin e tyre për përthithjen e goditjeve. Ky përmirësim i detyrohet një kapitali më të lartë rregullator, rënies së aktiveve të ponderuara me rrezik dhe fitimeve të rigjallëruara. Fitimet u nxitën prej rënies së provigjioneve dhe përmirësimit të të ardhurave neto nga interesi. Sidoqoftë, këto të ardhura mbetën nën presion ndërsa marzhi neto nga interesat paraqitet i ngushtë për një pjesë të madhe të bankave, ndikuar nga rritja e dobët e kredisë.

Në tremujorin e parë të vitit, kthimi mbi kapitalin (ROE) u përmirësua në 7.2% nga 4.5% në fund të 2010, por me një shpërndarje më të gjerë midis bankave. Kthimi mbi aktivet, avancoi në 0.53% për këtë tremujor, nga 0.34% në tremujorin e fundit të

2010. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit arriti në 13.4% në tremujorin e parë të vitit, për shkak të mbajtjes nga disa banka të një pjese të konsiderueshme të fitimit me qëllim rritjen e kapitalit.

Përveç gjithë kushteve të përmirësuar të GGMKB, mjedisi në të cilin ato operojnë mbetet sfidues. Perspektiva për ecurinë e tyre në të ardhmen mbetet e pasigurt, ndërkohë që disa prej tyre ende duhet të ripërtërihen plotësisht nga kriza. Për më tepër, ato janë ende të ekspozuara ndaj ndryshimeve në tregjet financiare, normave afatgjata të kthimit, si edhe çdo zhvillim tjetër negativ ekonomik apo fiskal, i cili mund të shtojë rreziqet për cilësinë e portofolit të kredisë apo aksesit në tregjet e financimit.

Edhe të dhënat e fundit për grupet e mëdha komplekse bankare (GMKB) në zonën e euros tregojnë se të gjitha burimet e të ardhurave u përmirësuan në fillim të 2011, ndërkohë që rënia e provigjioneve pati një ndikim të madh

mbi fitimet, edhe pse ekzistojnë ndryshime të dukshme midis institucioneve të ndryshme. Lidhur me zhvillimet më të fundit²⁸, vërehet se në tremujorin e dytë të 2011 disa banka evropiane kanë përmirësuar kapitalin e tyre apo e kanë njoftuar një rritje të planifikuar të tij. Sidoqoftë, për një pjesë të bankave, duhet të arrihet një nivel kapitali i një cilësie më të lartë, si edhe rënie e nivelit të levës financiare, për të siguruar një efekt zbutës ndaj humbjeve të mundshme në të ardhmen, si edhe një nivel besueshmërie më të lartë në tregje.

Duhet theksuar që ritmi i progresit në sistemin bankar është i pamjaftueshëm, veçanërisht në Evropë, ndërkohë që ekzistojnë rreziqe të lidhura me levën financiare në segmente të ndryshme të tregut²⁹.

²⁸ Financial Stability Review, June 2011

²⁹ Global Financial Stability Report (GFSR) Market Update

Hapësirë Informuese 1. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri

1. RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL (AUSTRI)¹

Totali i aktiveve të grupit Raiffesen Bank International shënoi një rritje prej 4.9% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, krahasuar me fundin e vitit 2010, duke arritur një vlerë prej rreth 137.6 miliardë euro. Vëllimi i kredive dhe paradhënive ndaj klientëve arriti vlerën e 79.4 miliardë euro, ndërkohë që depozitat e klientëve shënuan vlerën e 63.6 miliardë euro, respektivisht me një rritje prej 5% dhe 10.4% krahasuar me fundin e vitit të mëparshëm.

Fitimi neto i konsoliduar për gjashtëmujorin e parë të vitit ishte 615 milionë euro, 30.3% më i lartë se një vit më parë. Pavarësisht një rritje në të ardhurat operative me 2.3%, rezultati neto operativ ka rënë me 2.2% krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve të përgjithshme administrative.

Kthimi mbi kapitalin përpara tatimit u rrit me 4.9 pikë përqindje në 17.1% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit paraardhës, ndërsa kthimi mbi kapitalin pas tatimit u rrit gjithashtu, me 2.3 pikë përqindje, në një nivel prej 13.2%. Kthimi mbi aktivet u rrit me 0.5 pikë përqindje, duke u ngritur në 1.3%.

Banka Raiffesen në Shqipëri zinte rreth 1.51% të totalit të aktiveve të grupit Raiffesen Bank International, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011.

2. INTESA SANPAOLO (ITALI)²

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, totali i aktiveve të grupit Intesa Sanpaolo ishte 644.7 miliardë euro, duke rënë me 1.4% krahasuar me fundvitin 2010. Kreditë ndaj klientëve ranë me 1%, duke shënuar një vlerë prej 372.4 miliardë euro, ndërkohë që depozitat e klientëve dhe letrat me vlerë u pakësuan me 2.4% në 387.4 miliardë euro.

Të ardhurat neto patën një vlerë prej 1.4 miliardë euro, duke rënë kështu me 17% në terma vjetorë. Marzhi operativ u rrit me 12.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 4.2 miliardë euro për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për gjashtëmujorin e parë ishte 15.1% në krahasim me 13.2% në fund të vitit 2010.

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2011, Intesa Sanpaolo Bank në Shqipëri përbënte 0.14% të totalit të aktiveve të grupit Intesa Sanpaolo.

3. ALPHA BANK (GREQI)³

Banka Alpha kishte një total aktivesh prej rreth 63.4 miliardë euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, të pakësuara me rreth 4.6 miliardë euro ose me 6.7% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit paraardhës. Kreditë neto ranë me 6.7% në rreth 48 miliardë euro dhe depozitat shënuan gjithashtu një rënie prej 15.6% në 33.4 miliardë euro. Norma e kredive me probleme arriti në 10.3% në fund të gjashtëmujorit të parë. Ndërkohë, provigjionet e akumuluar në këtë gjashtëmujor ishin 2.5 miliardë euro. Të ardhurat operative u ulën me 1.5% në 1.1 miliardë euro në krahasim me një vit më parë, ndër të cilat të ardhurat neto nga interesi dhe komisionet ranë përkatësisht me 4.1% dhe 16.1%. Ndërkohë, shpenzimet operative pësuan një rënie prej 2.6%, ndikuar nga një rënie prej 3.3% e kostove të stafit dhe 2.9% e shpenzimeve të përgjithshme. Fitimi neto para tatimit për bankën Alpha ra ndjeshëm me 80.4%, në 27.6 milionë euro, ndërkohë që humbja neto për aksionerët ishte 524.8 milionë euro për këtë gjashtëmujor. Marzhi neto nga interesat u paraqit në të njëjtin nivel me një vit më parë, në një normë prej 2.7% ndërsa norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në një nivel prej 12.3%.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të 2011, Banka Alpha në Shqipëri përbënte rreth 0.76% të totalit të aktiveve të Bankës Alpha (Greqi).

4. PIRAEUS BANK (GREQI)⁴

Totali i aktiveve për grupin e Bankës Piraeus ishte në një nivel prej rreth 57.1 miliardë euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, me një rritje prej 1% mbi baza vjetore. Kreditë neto kanë rënë me 5%, duke shënuar një vlerë prej rreth 36.6 miliardë euro, ndërsa depozitat ranë me 11% në 26.3 miliardë euro. Raporti kredi/depozita u rrit me 936 pikë bazë, duke arritur një nivel prej 139%. Ndërkohë, edhe kreditë me probleme për këtë grup shënuan rritje, niveli i të cilave në fund të gjashtëmujorit ishte 9.6%.

Të ardhurat totale neto pësuan një rritje prej 7% krahasuar me një vit më parë, ndër të cilat rritja e të ardhurave neto nga interesat ishte 6%. Shpenzimet e provigjionimit u rritën me 38% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit paraardhës, duke patur një vlerë prej 371 milionë euro. Rezultati para tatimit për gjashtëmujorin e parë ishte negativ prej 1.004 milionë euro. Ndërkohë, humbja neto për aksionerët ishte 820 milionë euro për këtë gjashtëmujor.

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 9.5% në fund të gjashtëmujorit, nga 9.7% në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të 2011, totali i aktiveve të Bankës Tirana në Shqipëri përbënte rreth 1.1% të grupit të Bankës Piraeus.

5. NATIONAL BANK OF GREECE (GREQI)

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, totali i aktiveve të grupit të Bankës Kombëtare të Greqisë ishte 119.2 miliardë euro, duke rënë me 2% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit paraardhës. Kreditë kanë shënuar një rënie prej 1% mbi baza vjetore, duke arritur vlerën e 74 miliardë euro. Depozitat kanë pësuar gjithashtu një rënie prej 10%, në një vlerë prej 62.1 miliardë euro. Raporti kredi/depozita në fund të gjashtëmujorit ishte 110%, duke u rritur me 7 pikë përqindje ndaj gjashtëmujorit të parë 2010. Shpenzimet e provigjionimit për gjashtëmujorin e parë të vitit u rritën me 27% mbi bazë vjetore, duke arritur në 822 milionë euro. Shpenzimet operative të grupit ranë me 3% në terma vjetorë. Gjithashtu, marzhi neto i interesave ra në 3.65%, me një diferencë prej 33 pikësh bazë me një vit më parë. Fitimi neto i grupit ishte në një nivel prej 29 milionë euro në fund të gjashtëmujorit të parë. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të gjashtëmujorit ishte 11.2%.

Totali i aktiveve të degës së Bankës Kombëtare të Greqisë në Shqipëri në fund të gjashtëmujorit të parë 2011, përbënte rreth 0.25% të totalit të aktiveve të grupit të Bankës Kombëtare të Greqisë.

6. SOCIÉTÉ GÉNÉRALE (FRANCË)⁵

Totali i aktiveve për grupin Société Générale ishte 1,158 miliardë euro, në fund të

gjashtëmujorit të parë të 2011, me një rritje prej 2% në krahasim me fundvitin 2010. Bazuar në të njëjtën periudhë, kreditë për klientët u rritën me 1% në 376 miliardë euro, dhe depozitat e klientëve patën të njëjtën rritje, duke qëndruar në një nivel prej 341.4 miliardë euro.

Të ardhurat neto nga aktiviteti bankar në fund të gjashtëmujorit të parë, ishin 13.1 miliardë euro duke rënë me 1% në terma vjetorë, ndërkohë që shpenzimet operative u rritën me 6.8%. Të ardhurat neto të këtij grupi ishin 22.5% më të ulëta se një vit më parë, në një nivel total prej 1,663 miliardë euro.

Në fund të gjashtëmujorit të parë, kthimi mbi kapitalin (ROE) pas tatimit për grupin ishte 7.8% nga 11% në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 11.3% në fund të kësaj periudhe.

Në fund të gjysmës së parë të 2011, aktivet totale të Bankës Société Générale –Albania, përfaqësonin rreth 0.03% të totalit të aktiveve të grupit Société Générale.

7. CRÉDIT AGRICOLE (FRANCË)⁶ dhe EMPORIKI (GREQI)⁷

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2011, grupi Crédit Agricole raportoi një total aktivesh prej 1,726.8 miliardë euro. Kreditë dhe paradhëniet për klientët kishin një vlerë prej 775.5 miliardë euro duke u rritur me 2.1% ndaj fundit të vitit 2010, ndërsa depozitat e klientëve ishin 616.8 miliardë euro me një rënie prej 1.1%.

Për këtë gjashtëmujor, ky grup pati një rritje mbi bazë vjetore prej 4.8% në të ardhura, të cilat shënuan një nivel prej 18.1 miliardë euro. Shpenzimet operative u rritën me 1.6%, ndërkohë që rezultati neto pati një vlerë prej rreth 2.6 miliardë euro, në fund të gjashtëmujorit të parë, 25.1% më tepër se viti paraardhës.

Si pjesë e grupit Crédit Agricole, banka Emporiki në Greqi në fund të gjashtëmujorit të parë të 2011, pati një rritje prej 2.6% në terma vjetorë për të ardhurat neto nga aktiviteti bankar, me një vlerë prej 377.9 milionë euro. Shpenzimet totale të grupit Emporiki ranë me 19.4%, dhe si rrjedhojë rezultati operativ u rrit me 13.4%. Ndërkohë, rezultati pas tatimit ra me 14.2%.

Kreditë totale ranë në 22.6 miliardë euro, me 1.8% në terma vjetorë, ndërkohë që edhe depozitat kanë lëvizur në të njëjtin kah me një rënie prej 14.7%, në rreth 11 miliardë euro.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të 2011, Banka Emporiki në Shqipëri përbënte rreth 0.01% të totalit të aktiveve të grupit Crédit Agricole.

¹ Raporti i gjashtëmujorit të parë 2011, URL: <http://investor.rbinternational.com/index.php?id=498&L=1>

² Raporti i konsoliduar për 30 qershor 2011, URL: http://www.group.intesasanpaolo.com/script/sir0/si09/eng_index.jsp

³ Pasqyrat financiare për gjashtëmujorin e parë 2011, URL: <http://www.alpha.gr/page/default.asp?la=2&id=78&pl=291&pk=1107>

⁴ Pasqyrat financiare për gjashtëmujorin e parë 2011, URL: <http://www.piraeusbank.gr/ecPage.asp?id=300892&lang=2&nt=96&sid=&fid=294541>

⁵ Rezultatet e gjashtëmujorit të parë 2011, URL: <http://www.societegenerale.com/en/essentiel>
Pasqyrat financiare për gjashtëmujorin e parë 2011, URL: <http://www.credit-agricole.com/en/Finance-and-Shareholders/Financial-reporting/Credit-Agricole-S.A.-financial-results>

⁶ Pasqyrat financiare për gjashtëmujorin e parë 2011, URL: <http://www.piraeusbank.gr/ecPage.asp?id=300892&lang=2&nt=96&sid=&fid=294541>
[ases_story.jsp?docid=9260DB5ECEEE8FE9C7091BAB1574062&cabinet=PRESS_RELEASES&lang=gr](http://www.piraeusbank.gr/ecPage.asp?id=300892&lang=2&nt=96&sid=&fid=294541)

⁷ Rezultatet e gjashtëmujorit të parë 2011, URL: http://www.emporiki.gr/cbgen/gr/press/press_rele